

SYLLABUSI: Ndërmarrësia

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik		
Titulli i lëndës:	Ndërmarrësia		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i II-të, semestri IV-të		
Numri i orëve në javë:	2+1		
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS		
Koha / lokacioni:	Fakulteti Ekonomik Universiteti i Prishtinës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Safet Merovci		
Detajet kontaktuese:	safet.merovci@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Lënda e Ndërmarrësisë do të ligjërohet duke ju ofruar studentëve njohuritë më të reja në lëminë e Ndërmarrësisë, duke ju ofruar literaturën dhe problemet aktuale që takohen dhe debatohen në jetën akademike dhe praktike në këtë lëmi, njohuri kjo e domosdoshme për studentët tanë që të jenë në rrjedha të trendeve bashkëkohëore të bizneseve ndërkombëtare.		
Qëllimet e lëndës:	Me anë të kësaj lënde synohet që studentëve t’u ofrohen njohuritë themelore mbi çështjet teorike – shkencore në fushën e ndërmarrësisë. Thënë shkurt, qëllimet themelore të cilat pretendohen të arrihen janë: ngritja e ngrehinës që shpjegon se çka duhet bërë, dhe si duhet qasur qëllimit madhor të të mësuarit të studentëve, dhe të tjerëve, për ndërmarrësinë; të kuptuarit më të lehtë, të ndodhive dhe trendeve në biznesin e vogël privat në ekonominë kosovare dhe rolit crucial që luajnë ndërmarrësit në ndërtimin e një ekonomie të qëndrueshme; procesi i ndërmarrësisë, nga studentët dhe të tjerët, nga entuziastët e inovatorët, të përdoret si metodë e pasurimit të tyre, përmes zënjes së dijes, aftësive, dhe shkathtësive për të pasur sukses, jo vetëm si ndërmarrës, por edhe si qytetarë produktivë; ekzistojnë indikacione të forta se edukimi ndërmarrës do të prodhojë ndërmarrës më të mirë, dhe më të shumtë në numër, se sa që prodhoheshin më parë. Ky është qëllimi ynë madhor i leksioneve tona.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Ligjëratat nga disiplinat e Ndërmarrësisë do t’ju ofrojnë studentëve njohuri teorike dhe praktike të njohjes së teknikave të të menduarit ndërmarrës dhe përgatitja e tyre që të jenë ndërmarrës të suksesshëm.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej

Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume-teste	2	1	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet , etj	-	-	-
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe diskutime interaktive.		
Metodat e vlerësimit:	Sipas standardeve të avansuara të vlerësimit të UP: Në marrëveshje me studentët, mund të organizojmë provimin, me shkrim, me gojë ose të kombinuar (me gojë për notë më të lartë). Provimi kalohet edhe me teste (së paku dy kollokviume).		
Literatura			
Literatura bazë:	Emeric Solymossy & Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, Prishtinë, 2006.		
Literatura shtesë:	1. Rob Yeung, “The rules of Entrepreneurship”, 2007 2. “Entrepreneur’s Toolkit”, Harvard Business Essentials, 2005. 3. Jo Owen, “How to Lead”, Pearson prentice Hall, 2005. 4. Philip A. Wickham, “ Strategic Entrepreneurship”, Third Edition, Pearson Education Limited, 2004. 5. David E. Gumpert, “How to Really Start Your Own Business,” 4th edition, Lauson Publishing Co., 2003. 6. David E. Gumpert & Stanley R. Rich, “How to Write a Winning Business Plan,” (HBR OnPoint Article - Enhanced Edition), Pub. Date: January 01, 2001. 7. Robert Craven, “Kick-start your Business”, Virgin Publishing Ltd, 2001. 8. John B. Vinturella, “The Entrepreneur’s Fieldbook,” Prentice Hall, Upper Saddle River, 1999, New Jersey. 9. James F. Foley, "The Global Entrepreneur," 1999, published by Dearborn A Caplan Professional Company. 10. Michael Useem, “The leadership Moment”, Three Rivers Press, 1998. 11. Ron Johnson, “The 24 Hour Business Plan”, Century		

	Business, 1997. 12. Interneti.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje_Përmbajtja e leksioneve
Java e dytë:	Çka është ndërmarrësia dhe kush është ndërmarrës?
Java e tretë:	Vazhdim
Java e katërt:	Analiza dhe hulumtimet e tregut
Java e pestë:	Vazhdim
Java e gjashtë:	Studimi i Fizibilitetit
Java e shtatë:	Vazhdim
Java e tetë:	Test me shkrim
Java e nëntë:	Testimi i idesë ndërmarrëse
Java e dhjetë:	Vazhdim
Java e njëmbëdhjetë:	Blerësit
Java e dymbëdhjetë:	Planet e biznesit
Java e trembëdhjetë:	Përgaditja dhe menaxhimi i ndërmarrjes
Java e katërmëdhjetë:	Tregtia elektronike dhe matura e ndërmarrësit
Java e pesëmbëdhjetë:	Test me shkrim
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.</i> Statuti i Universitetit të Prishtinës Neni 155 Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë të drejtë: 1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve. Neni 156 Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë obligim: 1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti; 2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë; 3. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike; 4. Të vijojnë ligjërata në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve; Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre, për të mos e diskredituar Universitetin.	